



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 01/10/2012
Nr.0204 -1001

PËR: Naim Ismaili, Kryetar i Komunës Shtime
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit Komunës Shtime

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIEVE TË
KOMUNËS SË SHITES, NR. 01/187; 01/189; 01/192; 01/193; 01/194; 01/199
Pranuar me datë, 20/09/ 2012
Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimeve 01/187; 01/189; 01/192; 01/193; 01/194; 01/199 të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Shtimes me datë 06/09/2012, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtyre akteve dhe vlerëson se të njëjtat janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Aktet juridike të listuara si vijon, të cilat kanë efekt të plotë juridik.

- Vendimi për nxjerrjen në Diskutim Publik Propozim -Planinin Buxhetor të Komunës për periudhën 2013 -2015;
- Vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës - Shtime 01 Nr. 06/1146-148 për Muhamet Himay (Firma "Dragon Çelik") nga Prishtina;
- Vendimi për aprovimin e ankesës 01Nr.07/1247 të Zenel Ramadanit;
- Vendim për refuzimin e kërkesës 01Nr.07/1435 të Adem Tafa përfaqësues i firmës (NTP "Fatë") ;
- Vendim për aprovimin e rekomandimeve 01Nr. 06/1339-174 të Komitetit për Shërbimet Publike.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 01/10/2012
Br.0204 -1001

Za: Naim Ismaili, Gradonačelnik Opštine Štimlje
Kujtim Xhelili, Predsedavajući Skupštine Opštine Štimlje

Predmet: POTVRDA zakonitosti odluka Opštine Štimlje, br. 01/187; 01/189; 01/192; 01/193; 01/194; 01/199
Primljeno dana, 20/09/ 2012
Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjom po Zakonu za Lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluka 01/187; 01/189; 01/192; 01/193; 01/194; 01/199 usvojenih od Skupštine Opštine Štimlje, dana 06/09/2012, **POTVRDJUJE** zakonitost ovih akata i procenjuje da su isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravna Akta navdene u nastavku, koja imaju puni pravni efekat.

- Odluka o davanju na javnu raspravu Predloga Plana budžeta Opštine za period 2013 - 2015;
- Odluka o odlaganju odluke Skupštine Opštine - Štimlje 01 br. 06/1146-148 za Muhamet Himaj (Firma "Dragon Çelik") iz Prištine;
- Odluka za usvajanje žalbe 01br.07/1247 od Zenel Ramadani;
- Odluka o odbijanju zahteva 01br.07/1435 od Adem Tafa predstavnik firme (NTP "Fati") ;
- Odluka o usvajanju preporuka 01br. 06/1339-174 Odbora za javne usluge.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivu MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695, Datë: 23.8.2012



Npi – 01/187, Datë: 6.9.2012

Duke u Bazuar në nenin 40.2.b. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 60 dhe 61 të Ligjit për menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-48, si dhe nenit 8.1 të Rregullores për Transparencën 01Nr.06/361/4 të datës 04.03.2009, Kuvendi Komunal në mbledhjen e tetë të mbajtur më datën: 6.9.2012 mori këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK
PROPOZIM-PLANIN BUXHETOR KOMUNAL PËR PERIUDHËN 2013-2015

I


Kuvendi Komunal-Shtime në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën: 6.9.2012, unanimitisht aprovoi, Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik propozim- Planin Buxhetor Komunal për periudhën 2013-2015,

II.

Procesi i diskutimit publik do të zgjatë 15 ditë, duke filluar nga data 10.9.2012 deri më 25.12.2012. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Ekonomi dhe Financa në bashkëpunim me Komitetin për Politik dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, Zyrës për Informim, Kryetarit të Komunës, dhe MAPL-së.




Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695, Datë: 23.8.2012



Npi – 01/192, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal – Shtime në bazë të nenit 12, dhe 17.c, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe Statutit të Komunës së Shtimes, shqyrtoi Ankesën e banorëve të lagjes Luzhak të paraqitur nga z.Zenel Ramadani, Ankesa 01Nr.07/1245, të datës: 2.7.2012, me të cilën është kërkuar që Kuvendi Komunal edhe një herë të rishqyrtojë vendimin e Kuvendit Komunal-Shtime 01Nr.06/1146-148 datë:27.6.2012 për dhënien e Pëlqimit në kërkesën 01Nr.07/968, të datës: 18.05.2012, të z.Muhamed Himay, përfaqësues i firmës “Dragon Çelik” sh.p.k. për vendosjen e makinerisë për thërrmimin e gurëve natyror (Gurore) në pronën private të z.Shyqeri Bajraktarit nga lagja Luzhak, Z.K.Topillë-Devetak, në pjesët e Ngastrave Kadastrale 150-0, dhe 183-0 me gjithësejt 55 (pesëdhjetepesë) ari sipërfaqe. Banorët kanë kërkuar që ky vendim i Kuvendit të anulohet me arsyetimin se në këtë lagje jetojnë familje të cilat kanë pronat e tyre që i shfrytëzojnë për prodhime bujqësore, pastaj të ruhet ambienti i pastër dhe shëndeti i banorëve, si dhe të ruhet burimi i ujit dhe bukurit natyrore që ka kjo lagje. Duke pasë parasysh rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal-Shtime mori këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL – SHTIME
01Nr. 06/1146-148 PËR MUHAMED HIMAY (FIRMA “DRAGON ÇELIK”)
NGA PRISHTINA

I

Kuvendi Komunal - Shtime në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën:6.9.2012, me shumicën e votave aprovoi vendimin për Anulimin e vendimit të Kuvendit Komunal –Shtime 01Nr. 06/1146-148 të datës:27.6.2012, i cili ka të bëjë me kërkesën, 01Nr.07/968, të datës: 18.05.2012, të paraqitur nga z.Muhamed Himay, përfaqësues i firmës “Dragon Çelik” sh.p.k. me të cilin i është dhënë pëlqimi për shfrytëzimin e gjithësejt 55 (pesëdhjetepesë) ari sipërfaqe, nga pjesa e ngastrave kadastrale 150-0, dhe 183-0 Zona Kadastrale Topillë-Devetak. Evidentuar pronë private e z.Shyqeri Bajraktarit nga lagja Luzhak, me të cilin shfrytëzuesi z.Muhamed Himay, kishte kontratë 10 vjeçare për shfrytëzimin e sipërfaqes.

II

Vendimi është aprovuar sipas Rekomandimit të Komitetit për Politik dhe Financa.

III


Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695, Datë: 23.8.2012



Npi – 01/193, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi Ankesën 01Nr.07/1245 datë: 2.7.2012, të z.Zenel Ramadani, Adresa: rr. "Prishtinës" p.n. - Shtime, i cili ka paraqitur Ankesë, në emër të 72 banorëve të fshatit Luzhak, në Vendimin e Kuvendit Komunal-Shtime, 01Nr.06/1146-148 të datës: 27.6.2012, me të cilin kanë kërkuar që ky vendim me të cilin i është dhënë Pëlqimi për vendosjen e makinerisë për përpunimin e Gurit, z.Muhamed Himay-Prishtinë (Firma "Dragon Çelik") në lagjen Luzhak, Zona Kadastrale: Topillë-Devetak të rishikohet edhe një herë me arsyetimin se në këtë lagje jetojnë familje të cilat kanë pronat e tyre që i shfrytëzojnë për prodhime bujqësore, pastaj të ruhet ambienti i pastër dhe shëndeti i banorëve, si dhe të ruhet burimi i ujit dhe bukurit natyrore që ka kjo lagje. Prandaj kërkojmë që ky vendim të anulohet. Kuvendi Komunal, pasi analizoi Ankesën e palës, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M


PËR APROVIMIN E ANKESËS, 01Nr.07/1247
TË ZENEL RAMADANIT NGA SHTIMJA SI TË ARSYESHME

I

Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën:6.9.2012, me shumicën e votave vendosi që të aprovoi Ankesën 01Nr.07/1245, datë:2.7.2012 të Zenel Ramadani nga Shtimja, të paraqitur në emër të banorëve të lagjes Luzhak. Ankesa është pranuar si e arsyeshme dhe mbi bazën e saj është anuluar Vendimi i Kuvendit Komunal –Shtime 01Nr. 06/1146-148 të datës:27.6.2012, i cili ka të bëjë me Pëlqimin për z.Muhamet Himay (firma "Dragon Çelik") me qëllim të shfrytëzimit të 55 (pesëdhjetepesë) ari sipërfaqe, në ngastrat kadastrale 150-0, dhe 183-0 për Vendosjen e makinerisë për thërrmimin e gurit natyror, në pronën private të z.Shyqeri Bajraktarit nga lagja Luzhak, me të cilin shfrytëzuesi z.Muhamed Himay, kishte kontratë 10 vjeçare për shfrytëzimin e sipërfaqes.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695, Datë: 23.8.2012



Npi – 01/194, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, shqyrtoi kërkesën 01Nr.07/1435, datë: 25.7.2012, të z.Adem Tafa, (NTP – “Fati”) – Shtime, i cili ka kërkuar nga Kuvendi Komunal, dhënie në shfrytëzim, 1 (një) hektar tokë, pjesë nga Ngastra Kadastrale nr.1398/2 në Zonën Industriale, për ndërtimin e një Fabrike për therjen e kafshëve, si dhe përpunimin e mishit. Sipërfaqja evidentohet, pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime. Në kuadër të këtij projekti do të punësohen 20 punëtorë nga Komuna jonë. (Pala kërkesës i ka bashkangjitur një projekt ideor). Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi si dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M


PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, 01Nr.07/1435
TË ADEM Tafa PËRFAQËSUES I FIRMËS (NTP “FATI”) NGA SHTIMJA

I

Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën: 6.9.2012, me shumicën e votave vendosi që kërkesa 01Nr.07/1435 datë: 25.7.2012, e z.Adem Tafa, përfaqësues i (NTP – “Fati”) – Shtime, të Refuzohet me arsyetimin që hapësira nuk i plotëson nevojat, në mungesë të infrastrukturës fizike e sidomos kur është në pyetje therrja e kafshëve si dhe përpunimi i mishit. Inkurajohet pala që të hulumtoj ndonjë lokacion më të përshtatshëm.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695, Datë: 23.8.2012



Npi – 01/199, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 6.9.2012, shqyrtoi Rekomandimet e Komitetit për Shërbime Publike, 01Nr.06/1339-174, të datës: 19.7.2012. dhe mori këtë:

V E N D I M

**PËR APROVIMIN E REKOMANDIMEVE 01Nr.06/1339-174
TË KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE**

I


Kuvendi Komunal – Shtime në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më datën:6.9.2012, unanimisht ka vendosur ti përkrahë Rekomandimet, 01Nr.06/1339-174, të datës: 19.7.2012, të Komitetit për Shërbime Publike për çështjet që janë në kompetencë të Kuendit , ndërkaq për disa çështje të apostrofuara, për disa institucione në Komunë ne i Inkurajojmë që punët ti kryejnë konform Ligjit.

1. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të fillojë implementimin e Rregullores së re, mbi bazën e Ligjit për skemën Sociale në Qendrën për Punë Sociale në Shtime.
2. Që ekzekutivi të gjejë forma dhe mundësi për të ndikuar në zbutjen e çështjes sociale, të strehimit, banimit, punësimit si dhe të zbutjes së varfërisë, konform ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë këto fusha të caktuara. (Konkretisht KSHP- propozon që të ndahet një Lokacion, si dhe të dilet me një projekt konkret për ndërtimin e një objekti për banim kolektiv të rasteve sociale).
3. Inspektorati Komunal, të kontrollojë dhe të shqiptojë masa në bazë të rregullores, për bizneset të cilat nuk e respektojnë orarin e punës, si dhe lokalet të cilat tejkalojnë normat me zhurmë përmes muzikës.
4. Nga Policia kërkohet që krahas Ligjeve dhe Rregulloreve për prishjen e rendit dhe qetësisë publike të intervenohet dhe të dënohen rastet kur krijohet zhurmë, gjuhet me armë , etj. dhe tu konfiskohen mjetet e tilla.

Kryesuesi i Kuvendit, Rekomandimet do ti prezentoj edhe në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Kryesuesit të Komitetit për Shërbime Publike, Drejtorive, Përfaqësuesve të Institucioneve dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal..



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili